



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e I-rë për vitin 2012, e Kuvendit Komunal në
Vushtrri, mbajtur më 26.1.2012

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:12**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Ferit Idrizi - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- paraqiti rendin e ditës ashtu siç është paraparë në ftesë, kurse në “të ndryshme” propozoi që të futen:

- a. Propozim-vendimi për përmirësimin e Vendimit 01.Nr.59/11;
- b. Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara (të lira dhe të zotuar) nga të hyrat vetanake, nga viti 2011 në vitin 2012.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar ueb-faqes së Komunës së Vushtrrisë dhe informatave tjera, në Komunën e Vushtrrisë, në të cilën thuhet se për shkak të stuhisë dhe të reshurave ka pas dëme të konsiderueshme, ai kërkoi që kuvendi të informohet se cila ka qenë vlera e dëmeve të shkaktuara, a ka ndërmarrë komuna diçka për t’i ndihmuar familjet që kanë pësuar.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- propozoi që në “të ndryshme” të jetë një informatë lidhur me gjendjen e rrugëve në Komunën e Vushtrrisë, pas reshjeve të ditëve të fundit.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi në mënyrë unanime miratoi këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i raportit për punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2011.**
- 3. Shqyrtimi i raportit për punën e Komitetit për Komunitete për vitin 2011.**
- 4. Shqyrtimi i raportit për punën e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2010/2011.**
- 5. Shqyrtimi i raportit për punën e Komitetit Konsultativ për Ekonomi dhe Shërbime Publike për vitin 2010/2011.**
- 6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për hartimin e planeve rregulluese urbane në Komunën e Vushtrrisë.**
- 7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për emërimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese të komunës.**
- 8. Të ndryshme:**
 - a. Shqyrtimi i propozim-vendimit për përmirësimin e Vendimit 01Nr.59/11;**
 - b. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara (të lira dhe të zotuar) nga të hyrat vetanake, nga viti 2011 në vitin 2012;**
 - c. Shqyrtimi i Informatës për dëmet e shkaktuara dhe gjendjen e rrugëve në Komunën e Vushtrrisë, pas reshjeve të ditëve të fundit;**
 - ç. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.**

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së KK-së, pa vërejtje dhe sugjerime.

- 2. Shqyrtimi i raportit për punën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2011.**

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me raportin në fjalë, dhe kërkoi që në raport të korrigjohet në vend të “çdo muaj” të thuhet “çdo tre muaj” kur flitet për informimin e kuvendit për të hyrat vetjake nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se te përmbajtja duhet të figurojnë këto rubrika: “anulimet e kuvendit të komunës”, “pyetjet e anëtarëve të kuvendit”, pra të paraqitet numri i pyetjeve të parashtruara dhe numri i përgjigjeve të dhëna. Pastaj në fq. 4 propozoi që të theksohet se për disa pyetje të anëtarëve të kuvendit, nuk janë dhënë përgjigje. Mandej në fq. 5 nuk janë përmendur anulimet e disa vendimeve të kuvendit, dhe gjithashtu nuk janë përmendur disa vendime të kuvendit që janë marrë duke shkelur procedurat. Kurse në fq. 6, propozoi që të paraqiten edhe 30 rekomandime tjera të dhëna nga KPF-ja, duke shtuar tek rekomandimet edhe pajisjen me nga një laptop për anëtarët e kuvendit. Gjithashtu propozoi që KPF-ja të jetë me e kompletuar me disa rekomandime, sidomos për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, dhe Drejtorinë për Prokurim, dhe shtoi se KPF-ja është dashtë të paraqesë rekomandime lidhur me dy diskutimet publike të kryetarit të komunës me qytetarët. Në fund propozoi që të përmendet në raport edhe marrja e çmimit (shpërblimit) si kuvendi më transparent dhe më i suksesshëm në Republikën e Kosovës, dhe të përmenden edhe rastet e shkeljes së Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe Rregullores së punës së kuvendit.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar vërejtjes së Q.Azemit rreth rekomandimeve tha se, rekomandimet e paraqitura në raport nuk janë rekomandime të KPF-së, por janë rekomandime të kuvendit që i adresohen ekzekutivit.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se raporti në fjalë ka nevojë për shumë përmirësime edhe në formë, edhe në përmbajtje, dhe shtoi se raporti i punës duhet të krahasohet me planin e punës, pasi që nuk është paraqitur një elaborim i realizimit të synimit, qëllimeve dhe objektivave sipas prioriteteve që ka përcaktuar kuvendi i komunës. Mandej tha se nuk është përfshirë esenca në raport, pasi që është dashtë të pasqyrohet se sa kuvendi i komunës me vendimet e veta ka kontribuar në zhvillimin ekonomik, punësimin, pastërtinë e ambientit, kursimin e ujit dhe furnizimin më të rregullt me ujë, zbatimin e ligjshmërisë, rritjen e transparencës, përmirësimin e ambientit më të favorshëm ndërmarrës, nxitjen dhe lindjen e zhvillimit të bizneseve, përmirësimin e gjendjes në arsim dhe shëndetësi. Gjithashtu, tha se raporti është përshkruar me një megalomani të fjalive, duke shtuar se ka fjali të panevojshme në raport siç është fjalia: “të gjitha mbledhjet i ka thirrur dhe kryesuar kryesuesi i kuvendit”. Kurse lidhur me mbledhjet e jashtëzakonshme të paraqitura në raport, tha se nuk është dashtë të paraqiten pikat e rendit të ditës, por është dashtë të pasqyrohen rezultatet. Ndërkaq në fq. 5 thuhet “se kontributi i shoqërisë civile ishte shumë i vogël, prandaj mbetet të hulumtohen shkaqet në të ardhmen”, prandaj propozoi që kjo fjali të riformulohet, dhe pyeti pse është kontributi i tyre i vogël dhe cili është mekanizmi me të cilin do të matet kontributi i tyre? Mandej në raport përmendet vizita në Shqipëri e anëtarëve të kuvendit, dhe menjëherë pas asaj fjalie, pa asnjë fjalë tjetër pason një tabelë, prandaj ai propozoi që të vendoset paraprakisht një titull që flet për përmbajtjen e tabelës, kurse tek tabela mungon nxjerrja e përqindjes, dhe në tabelën në fjalë është dashtë të paraqitet edhe një rubrikë ku do të tregohej se sa prej këtyre vendimeve janë implementuar. Në vazhdim tha se raporti ka edhe këto mangësi: nuk është cekur se të njëjtat vërejtje që i jepen Drejtorisë për Buxhet dhe Financa nga anëtarët e kuvendit janë të papërmirësueshme, nuk është përmendur në raport se sa shkelje ligjore ka konstatuar Zyra Ligjore e MAPL-së, lidhur me tabelën e paraqitur ku flitet për aprovimin e pikave të rendit të ditës me shumicë, tha se është dashtë të paraqitet një analizë pse kjo ka ndodhur, dhe gjithashtu raporti duhet të përgjigjet lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e kuvendit, e të cilët nuk i kanë marrë përgjigjet e plota, duke shtuar se ka pasur mangësi dhe lëshime të qëllimshme. Lidhur me shpërndarjen e materialeve, tha se nuk është bërë me kohë dhe në harmoni me ligjin, dhe gjatë mbledhjeve të KK-së kanë ardhur gjithmonë materiale shtesë, dhe dështimi i mbledhjes së KK-së në muajin mars është dashtë të elaborohet pse ka ndodhur; me planin e punës së kuvendit edhe pse është paraparë ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së punës së kuvendit, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, gjithashtu nuk janë përmendur vendimet e shfuqizuara; nuk janë përmendur në raport se sa propozime të grupeve parlamentare janë aprovuar gjatë mbledhjeve të KK-së dhe që janë proceduar. Në fund kërkoi që të përfshihet në raport edhe marrja e shpërblimit si kuvendi më transparent, dhe në mbledhjen e radhës së KK-së të vijë si raport i kompletuar.

Xhylsime Feka, anëtare e kuvendit- tha se raporti në fjalë është i bazuar në gjendjen reale dhe faktike, i cili përshkruan me hollësi dhe në mënyrë koncize punën e kuvendit për periudhën njëvjeçare. Mandej tha se raporti është hartuar konform planit të punës së kuvendit, punës dhe ngjarjeve që e kanë karakterizuar kuvendin e komunës, dhe në këtë drejtim është paraqitur përmes një qasjeje të shëndoshë, reale, transparente dhe demokratike, dhe puna e kuvendit shënohet në formën pozitive që mund të shërbejë si model për funksionimin e suksesshëm edhe për kuvendet tjera. Gjithashtu tha se raporti në fjalë përmban edhe rekomandime, që kur të merren parasysh, do të ngrisin nivelin e punës dhe performancës së kuvendit

të komunës. Në fund tha se Grupi parlamentar i PDK-së e vlerëson si një raport gjithëpërfshirës, real dhe me pasqyrim të qartë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar rekomandimeve të paraqitura në raportin në fjalë, tha se përveç rekomandimeve që janë në raport, duhet të përfshihet edhe rekomandimi që materialet për mbledhjet e KK-së t'iu shpërndahen anëtarëve të kuvendit në pajtim me Statutin e komunës. Pastaj tha se në planin e punës së kuvendit për vitin 2011, por edhe në revistën komunale "Viciansa" për muajin dhjetor ka qenë e paraparë që kryetari i komunës të paraqes planin e tij të punës para kuvendit, dhe shtoi se anëtarët e kuvendit duhet të informohen me planin në fjalë dhe të japin kontributin e tyre, në mënyrë që kryetari ta ketë një plan të kompletuar. Gjithashtu tha se në raport do të duhej të përfshihej edhe mosplotësimi dhe mosndryshimi i Rregullores së punës së kuvendit, edhe pse ka qenë e planifikuar më parë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- duke iu referuar vërejtjeve të shefit të Grupit parlamentar të LDK-së lidhur me pikat shtesë të rendit të ditës, tha se këtë shumë mirë e parasheh statuti i komunës në nenin 48.2, ku mundëson propozimin dhe plotësimin e rendit të ditës me pika shtesë. Pastaj tha se mbledhjen e muajit mars, Grupi parlamentar i PDK-së e ka sqaruar pse nuk e ka votuar rendin e ditës, ndërsa sa i përket shpërndarjes së materialit të mbledhjeve të KK-së për anëtarët e kuvendit, tha se materiali është duke u shpërndatë në përputhje me LVL-në. Në fund tha se plani i punës i kryetarit të komunës iu është dërguar përmes postës elektronike të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se është një raport i rëndomtë, i cili flet për punën e kuvendit të komunës dhe si i tillë nuk mund të hudhet poshtë, mirëpo mund të plotësohet me propozimet e paraqitura nga anëtarët e kuvendit, por nuk është e mundur që brenda një raporti të trajtohen të gjitha detajet. Në fund tha se duhet të paraqiten në raport edhe vendimet të cilat nuk janë zbatuar.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se gjatë hartimit të raportit në fjalë nuk janë marrë parasysh vendimet e dy mbledhjeve të jashtëzakonshme të KK-së, në numrin e përgjithshëm kur janë numëruar në tabelë se sa vendime janë marrë. Pastaj tha se gjatë vitit 2011, vetëm për tri mbledhje është respektuar neni 43.3 i LVL-së për shpërndarjen e materialeve, e që duhet të jetë 7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar çështjes së shpërndarjes së materialit konform nenit 43.3 të LVL-së, tha se as në të kaluarën nuk ka mundur të respektohet neni në fjalë, por nuk do të mund të respektohet as tani, mirëpo ky nen duhet të ndryshohet, pasi që është e pamundur të procedohen në mënyrën qysh e parasheh LVL-ja. Kurse lidhur me planin e punës së kryetarit, tha se kryetari i komunës nuk është i obliguar që ta paraqesë para kuvendit të komunës planin në fjalë, edhe pse rikujtoi se ua ka dërguar të gjithë anëtarëve të kuvendit përmes postës elektronike. Në vazhdim duke iu referuar rekomandimit në raportin e punës së kuvendit, ku thuhet se drejtorët e drejtorive që kanë proceduar materiale për KPF dhe kuvend duhet të marrin pjesë në mbledhje, tha se të gjithë drejtorët e drejtorive janë të obliguar dhe kanë prezantuar në shumicën e mbledhjeve.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar vërejtjeve dhe sugjerimeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me raportin në fjalë, tha se do të inkorporohen në raport sugjerimet e paraqitura, mirëpo specifikat e përmendura nuk futen në raport, pasi që janë procesverbalet. Në fund lidhur me rekomandimin që drejtorët të jenë prezent, tha se ka pasur raste kur në KPF kanë proceduar materiale, por drejtorët përkatës kanë munguar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota "për", të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:

Aprovohet raporti i punës në fjalë, duke inkorporuar vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të kuvendit.

3. Shqyrtimi i raportit për punën e Komitetit për Komunitete për vitin 2011.

Milan Kostic, kryesues i Komitetit për Komunitete- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me raportin në fjalë. Kurse për vitin 2012 njoftoi se Komiteti për Komunitete do të formojë grupe punuese, të cilat do t'i vizitojnë vendbanimet ku banojnë komunitetet në mënyrë që të informohet Komiteti për Komunitete më për së afërmi lidhur me problemet e tyre.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- fillimisht shprehu brengosjen që anëtarit të Grupit parlamentar të LDK-së nuk iu dha mundësia e replikës. Pastaj duke iu referuar raportit në fjalë, tha se në raport janë paraqitur pikat e rendit të ditës, por është dashtë të mos emërtohen pika të rendit të ditës, por si kërkesa që ka adresuar komiteti në fjalë, pasi që është e pakuptimtë që në raport të paraqiten pikat e rendit të ditës, dhe është dashtë të përmendet niveli i implementimit të kërkesave në fjalë. Mandej tha se është dashtë të raportohet për: eficiencën e këtij komiteti karshi problemeve dhe sfidave me të cilat ballafaqohet Komuna e Vushtrrisë; sa ka kontribuar ky komitet në integrimin e komuniteteve në institucionet lokale; sa ka kontribuar ky komitet për nxitjen e të bërit biznes nga komunitetet pakicë, ose ndonjë përpjekje e këtij komiteti për nxitjen e të bërit biznes të përbashkët të dy a më shumë komuniteteve; sa çështje të propozuara nga komiteti në fjalë janë proceduar në kuvend dhe cilat janë autputet?

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke e vlerësuar raportin në fjalë, shtoi se brengat e komuniteteve të prezantuara në këtë mënyrë duhet të adresohen ndryshe, dhe të elaborohen, prandaj komuna e cila ka kufijt dhe kompetencat e veta për arsim, shëndetësi dhe për subvencione tjera duhet t'i ndihmojë në mënyrë më specifike komunitetet. Gjithashtu kërkoi nga komiteti në fjalë që kuvendit t'i adresojë rekomandime të pranueshme për t'i votuar dhe ekzekutuar.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- pasi që e vlerësoi angazhimin dhe raportin e Komitetit për Komunitete, tha se puna e komitetit në fjalë nënkryesimin e mëparmë nuk ka qenë e mirë, dhe nuk kanë raportuar asnjëherë, prandaj si kryetar i komunës ka kërkuar që t'i reduktojnë takimet nga njëmuajore në tremujore. Prandaj tha se është me rëndësi që kryesuesi i ri i këtij komiteti ka një angazhim më serioz, dhe me prezantimin e sotëm po tregohet që komuniteti serb ka filluar të integrohet në institucionet e komunës, dhe shtoi se do të trajtohen kërkesat e tyre, ashtu siç janë trajtuar edhe në të kaluarën.

4. Shqyrtimi i raportit për punën e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2010/2011.

Hamit Khaferi, kryesues i KK për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me raportin në fjalë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar rekomandimeve të paraqitura në raportin në fjalë, i propozoi komitetit në fjalë që të fut në rekomandime edhe disa çështje tjera, siç janë: problemi i furnizimit me ujë të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë, për të cilin kërkoi një raport më të thuktë për pusët në vendet rurale, pasi që për shkak të mungesës së ujit, po bëhet edhe ndotja e tij nëpër shkolla dhe nëpër shtëpi private; mandej problemi i çështjes së bukës, pasi që buka e cila është me aditiv të tepruar po rrezikon shëndetin publik; si çështje tjetër ai ceku problemin e rrezikut nga azbesti dhe lesioniti, dhe në fund e mbështeti raportin në fjalë.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit- pasi që mbështeti raportin në fjalë, tha se Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe QKMF-ja kanë kontribuar lidhur me organizimin e punës dhe ofrimit të shërbimeve mjekësore ndaj pacientit,

duke bërë zonimin e pacientëve dhe caktimin e terminit për kontrollin mjekësor. Gjithashtu tha se zonimi i pacientëve ka ndikuar pozitivisht në trajtimin më të mirëfilltë të pacientëve, dhe ka zhdukur fluksin e madh të pacientëve nga qendrat e mjekësive familjare jashtë qytetit, që në të kaluarën e kanë frekuentuar QKMF-në. Kurse lidhur me subvencionet, propozoi që të bëhet një planifikim më racional dhe proporcional në të gjithë muajt e vitit.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se infrastruktura ligjore duhet të harmonizohet me ligjet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Kuvendit të Kosovës, e cila aktualisht në Kosovë nuk është në funksion të plotë. Gjithashtu kërkoi që të bëhet ngritja dhe edukimi i vazhdueshëm i personelit, i cili është bartës i punës në QKMF-të. Mandej tha se çështja e furnizimit me barëra esenciale në nivel të Kosovës është problem shumë serioz për shkak se po rrezikohet pjesa më e madhe e gjeneratës së tretë, e cila ka nevojë për medikamente, por nuk kanë mundësi t'i blejnë, prandaj një përgatitje më e mirë do ta zbuste këtë problem edhe me donacionet ndërkombëtare. Ndërsa zonimi i pacientëve duhet vlerësuar pozitivisht, dhe kërkon kohë, qasje dhe është hapi i parë për disiplinimin dhe orientimin që secili pacient ta merr udhëzimin e duhur. Pastaj tha se çështja e komisioneve disiplinore, profesionale dhe pushimeve mjekësore kanë mbetur të padeterminuara. Kurse çështja e shëndetit publik në nivelin e Komunës së Vushtrrisë ka një rol shumë të rëndësishëm që qytetarët të marrin informata të duhura nga aspekti profesional prej atyre që janë kompetent edhe në drejtori edhe në shëndetësi për ujin, ushqimin, barërat dhe për të gjitha ato që kanë ndikim direkt në shëndetin e tyre. Gjithashtu tha se është mirë që drejtorja ta informojë inspektoratin në nivelin e Ministrisë së Shëndetësisë që sterilizimin e mjeteve të duhura për punë nga ana e stomatologëve, gjinekologëve, kirurgëve dhe të gjithë të tjerëve ta ketë nënmbikëqyrje, pasi që burim dhe shkaktar i hepatit C janë mjetet që nuk janë sterilizuar. Në vazhdim tha se komiteti konsultativ në fjalë është dashtë që në konkurs të përfshijë edhe njerëz tjerë që kanë përvojë të të gjitha lëmive, edhe pse janë pensionuar, në mënyrë që të japin një pasqyrë të kompletuar me vërejtjet dhe sugjerimet e veta, që të ndërtohet një sistem i pranueshëm dhe i arsyeshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë për ndihmë, për ata që kanë nevojë. Në fund lidhur me çështjen sociale, tha se do të barten kompetencat nga ministria në komunë, dhe komuna do të ballafaqohet me një problem shumë të rëndë, prandaj edhe për strehim, subvencione dhe për trajtime tjera është një kriter që duhet respektuar, dhe kërkoi që të respektohet kriteri profesional dhe t'i ndihmohet atij që duhet dhe që ka nevojë në bazë të moshës dhe sëmundjes, gjithashtu kërkoi që në kuadrin e qendrës për punë sociale të bëhet një vlerësim i potencialit kadrovik, strukturës së tij dhe çfarë raporti ka me kuvendin e komunës.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se shihet që në Komunën e Vushtrrisë nuk është një gjendje e mirë, sidomos për faktin që 80 familje janë të pastrehë, prandaj është mirë që komuna ta hartojë një listë të këtyre familjeve të pastreha, dhe në rastin kur të krijohen mundësitë qoftë nga donacionet apo edhe me kontribute të tjera, t'iu dilet në ndihmë për t'ua siguruar strehimin. Gjithashtu lidhur me çështjen e varfërisë, tha se është mirë që të hartohet lista e atyre qytetarëve të cilët vuajnë nga sëmundjet kronike, që në pamundësi për të blerë barërat, mund të ballafaqohen me probleme të ndryshme, prandaj propozoi që në të ardhmen Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në bashkëpunim me Komitetin Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe me Qendrën për Punë Sociale të paraqesin një raport të thuktë lidhur me këto kategori.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit- pyeti se komiteti konsultativ në fjalë a ka diskutuar lidhur me çështjen e personave me aftësi të kufizuara, pasi që kjo kategori e shoqërisë ka nevojë për përkrahjen tonë, pasi që ndihma që iu ndahet këtyre personave prej 50 €, është ndihmë shumë e vogël, dhe si e tillë kjo ndihmë nuk i

plotëson kërkesat dhe nevojat e tyre, prandaj kërkoi që ky komitet ta ngritë zërin në favor të kësaj kategorie.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit- pasi që e vlerësoi pozitivisht raportin në fjalë, i rekomandoi Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që rekomandimet që janë paraqitur në këtë raport, t'i implementojë, dhe njëkohësisht sugjeroi që të koordinohen punët në mes të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe komitetit konsultativ në fjalë, dhe çdoherë kur paraqitet ndonjë kontest në drejtorinë në fjalë të konsultohet me komitetin konsultativ, pasi që ky komitet është ndihmesë e madhe për drejtorinë përkatëse. Në fund kërkoi nga komiteti konsultativ që të informohet mirë rreth gjendjes shëndetësore në Komunën e Vushtrrisë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se ky komitet konsultativ në bazë të udhëzimit administrativ që iu ka referuar, do të duhej të paraqiste propozim-vendime të caktuara, për t'i proceduar dhe aprovuar në kuvend, dhe në këtë mënyrë të bëhen të obligueshme për ekzekutivin. Pastaj i rekomandoi komitetit konsultativ që të propozoi një akt për kuvendin që të bëhet kontrolli sistematik shëndetësor i fëmijëve duke filluar nga shkollat e rangut më të ultë deri në rangun më të lartë në Komunën e Vushtrrisë, pasi që kjo do t'i ndihmonte shumë identifikimit të infeksioneve dhe epidemive, gjithashtu propozoi që këtij kontrolli t'i nënshtrohet edhe personeli arsimor.

5. Shqyrtimi i raportit për punën e Komitetit Konsultativ për Ekonomi dhe Shërbime Publike për vitin 2010/2011.

Sabit Nura, kryesues i KK për Ekonomi dhe Shërbime Publike- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me raportin në fjalë.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar raportit në fjalë, tha se nuk ka ndonjë rekomandim të qartë për zhvillimin ekonomik dhe janë paraqitur të përziera punët që i takojnë zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve publike. Pastaj tha se si rekomandime që i ndihmojnë zhvillimit ekonomik mund të jenë: identifikimi i bizneseve aktive; numri i të punësuarëve në sektorin privat dhe publik; numri i papunësisë në Komunën e Vushtrrisë, dhe shtoi se këto të dhëna statistikore kishin me qenë shumë të rëndësishme për zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se raporti në fjalë nuk i gjason raportit, dhe shtoi se roli i komitetit konsultativ në fjalë është që nga drejtoritë përkatëse të merrë informata, kurse komiteti duhet të jepë sugjerime, propozime dhe rekomandime. Pastaj paraqiti vërejtje për formën e përpilimit të rekomandimeve të dhëna në raport, duke shtuar se janë fjali të përgjithësuar. Mandej tha se në raport asgjë nuk është folur për aleancën e bizneseve, për planin strategjik, nuk është folur as për skemën organizative; as për ngritjen e bujqësisë dhe asnjë elaborat për dëmtimin e pyjeve.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- tha se në raportin në fjalë përmendet eliminimi i qenve endacak në qytet dhe në pjesët rurale, dhe shtoi se këtë punë duhet ta bëjë stacioni i veterinarisë së bashku me Shoqatën e gjuetarëve, në interes të mbrojtjes së qytetarëve nga kafshimi i qenve endacak.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- pasi që e vlerësoi pozitivisht paraqitjen e raportit në fjalë, tha se një komitet konsultativ për të dhënë kontributin, duhet ta ketë edhe mbështetjen financiare. Kurse lidhur me rekomandimet e paraqitura në raport, tha se janë të përgjithësuar. Mandej tha se ky komitet e ka për obligim që të krijojë lehtësira në zhvillimin ekonomik në Komunën e Vushtrrisë, duke paraqitur propozime, rekomandime dhe sugjerime, por kërkoi që kur të paraqiten rekomandimet, ato të jenë të precizuara. Në fund lidhur me ruajtjen e tokave bujqësore, tha se duhet të hulumtohet mekanizmi se si duhet të implementohet ruajtja e tokave bujqësore dhe pjellore nga ndërtimet.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- e vlerësoi pozitivisht paraqitjen e raportit në fjalë. Pastaj tha se është dashtë të udhëzohet komiteti konsultativ në fjalë që të mos thuhet se kompetencat e kuvendeve të komunave përcaktohen sipas udhëzimit administrativ, pasi që kompetencat e kuvendeve të komunave përcaktohen me LVL, kurse në rastin konkret në nenin 17 të LVL-së përcaktohen kompetencat vetanake, duke mos i përfshirë ato të deleguarat, prandaj komitetet konsultative duhet ta kenë bazë juridike nenin ku përcakton fushëveprimet e caktuara. Në fund sugjeroi komitetet konsultative që të kenë koordinim me asociacionet tjera të organizuara, në mënyrë që të marrin ide prej tyre.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se puna e këtij komiteti konsultativ, por edhe e komiteteve tjera konsultative e kanë për qëllim mbështetjen në aspektin profesional të drejtorive të qeverisë komunale, duke dhënë udhëzime, sidomos kur bëhet fjalë për projekte të ndryshme, mirëpo komitetet konsultative janë si udhëzues edhe për KPF-në, por edhe për kuvendin, prandaj sugjeroi që secili komitet ta përcjellë fushën e vet, duke e vëzhguar gjendjen në komunë, kurse drejtoritë duhet të kërkojnë këshilla nga komitetet konsultative për projektet e veçanta. Në fund njoftoi se të gjitha komiteteve konsultative do t'iu kompensohen të gjitha mbledhjet e realizuara gjatë viteve 2010-2011.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- tha se është shumë me rëndësi që komitetet konsultative të njoftohen me buxhetin që është i ndarë për secilën drejtori, duhet të pajisen me planifikimin e projekteve, dhe në këtë mënyrë të japin kontributin e tyre profesional.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për hartimin e planeve rregulluese urbane në Komunën e Vushtrrisë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se propozim-vendimi në fjalë paraqet një propozim problematik për Komunën e Vushtrrisë, i cili përkundër qëllimit të mirë që të rregullojë zhvillimin hapësinor dhe urbanistik të komunës, rrezikon të sjellë efekte negative dhe të dëmtojë zhvillimin në fjalë, duke shtuar se hartimi i planeve rregullative urbane sipas vendimit të propozuar rrezikon të jetë i dëmshëm, dhe propozim-vendimi i propozuar përmban një varg shkeljesh të cilat vënë në dyshim qëllimin e tij. Gjithashtu tha se në listimin e planeve rregulluese urbane të propozuara thuhet, por nuk ipen as në arsyetim prioritetet në bazë të të cilave është përpiluar kjo listë e planeve, po ashtu nuk ka argumentim për nevojat e hartimit të këtyre planeve, shkallën e rëndësisë dhe përfitimet konkrete të komunës dhe qytetarët e Vushtrrisë, në rast se këto plane hartohen. Mandej duke iu referuar nenit 2 të propozim-vendimit në fjalë, tha se radhitja e listës së planeve rregulluese urbane për hartim, nuk përkon me sugjerimet e planit zhvillimor komunal dhe planit zhvillimor urban, plane këto të cilat janë hartuar nga komuna, dhe do të duhej të respektoheshin gjatë zhvillimit të komunës si plane prioritare. Në vazhdim tha se zona përgjatë magjistrales Prishtinë-Mitrovicë bie në kundërshtim edhe me planet paraprake të lartpërmendura. Pastaj tha se rruga magjistrale do të duhej të mbrohej me një vendim të veçantë, i cili do të duhej të ndalonte çdo ndërtim në distancë prej 60 metrave nga aksi i rrugës në fjalë, por nëse ka kërkesë për ndonjë ndërtim pranë saj, nuk do të duhej të jepej leja, përveç rasteve kur argumentohet se ndërtimi në fjalë pason me hapjen e vendeve të konsiderueshme të punës dhe gjeneron një ekonomi solide për vendin, ndërsa të gjitha rastet e ndërtimit përgjatë magjistrales në tokë bujqësore duhet të merrnin leje të përkohshme dhe të taksoheshin me një vlerë të lartë për të krijuar fondin për zhvillim të bujqësisë dhe mënjanim të ndërtimeve të tilla. Po ashtu tha se hartimi i planit rregullues për qytet, për zonën 4 deri 17 është i mirëpritur për qytetarët, dhe hartimi i mirëfilltë i tyre do të lehtësonte funksionimin komunal dhe zhvillimin urban të qytetit, mirëpo hartimi i mirëfilltë i tyre duhet të arsyetohet me buxhet përkatës, dhe shtoi se hartimi i mirëfilltë i tyre nga një

kompani serioze do të kushtonte rreth 500.000 €, kurse në buxhetin e komunës janë paraparë rreth 60.000 € për hartimin e planeve rregulluese për këtë vit, prandaj nëse komuna nuk i ka këto të holla, hartimi i planeve shkel e shko, siç është bërë në tri planet rregulluese urbane për zonën I, II dhe III, nuk është i pranueshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë dhe nuk sjell përfitime. Në fund tha se Komuna e Vushtrrisë nuk ka buxhet t'i hartojë 15 plane përnjëherë gjatë këtij viti, prandaj Grupi parlamentar i LDK-së nuk do ta përkrah në këtë formë propozim-vendimin në fjalë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se çështjen e planit zhvillimor komunal dhe planit zhvillimor urban duhet shikuar në mënyrë të gjithanshme dhe duhet analizuar se cili është interesi i qytetarëve, çfarë është interesi i zhvillimit të komunës përmes saj, prandaj në rastin konkret në arsyetimin e këtij propozim-vendimi nuk është paraqitur se cili është interesi i qytetarëve të komunës. Kurse lidhur me nenin 2 të propozim-vendimit në fjalë, ku parashihen rreth 480 ha e tokës së klasës së parë, kryesisht tokë nën sistemin e ujitjes, në emër të Grupit parlamentar të AAK-së kërkoi që të shqyrtohet në mënyrë më serioze. Në vazhdim, duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, kërkoi që të analizohet, të ndahet, dhe jo të përfshihet në tërësi, duke shtuar se ka raste kur objektet e përkohshme po shndërrohen në objekte të përhershme, prandaj në këtë mënyrë po degradohet ardhmëria jonë, po degradohet toka, që është pasuria e madhe e komunës, dhe për këtë arsye kërkoi që të shikohet interesi i përgjithshëm i komunës, e jo interesat e ngushta individuale të qarqeve të caktuara.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- tha se është më se i nevojshëm aprovimi i propozim-vendimit në fjalë, sepse përmes tij mund të krijohen hapësira të reja, dhe të vëhet në rend edhe ndërtimi, kurse pa të, pasojat janë të mëdha.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, kërkoi që sa më shumë të ruhet toka e bukës, pasi që për çdo ditë po pakësohet, dhe e kundërshtoi propozimin që në anën e djathtë të magjistrales Vushtrri – Prishtinë të jenë 150 metra në dispozicion, dhe propozoi që në anën e djathtë gjendja aktuale të ngrihet ashtu siç është, dhe të mos ketë leje ndërtimi për pjesën që shkon përgjatë magjistrales deri në Prishtinë, ose të reduktohet nga 150 metra në 100 metra, pasi që toka e bukës po gllabërohet në mënyrë të rrefeshme. Ndërsa në pjesën e majtë të magjistrales në fjalë, propozoi që të zgjerohet plani rregullues urban. Në fund lidhur me rrugën që shkon nga Vushtrria deri te pompa e benzinës që lidhet me Artakollin, tha se ka filluar zënia e tokave, prandaj kërkoi që të mos lejohet zënia e tokës në fjalë, pasi është tokë nën ujitje.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se çështjet e tilla siç është hartimi i planeve rregulluese urbane meritojnë vëmendje dhe seriozitet maksimal, dhe shtoi se sot në Kosovë ka probleme të shumta, për shkak të mungesës së planeve rregulluese, pra të definimit të këtyre çështjeve, prandaj drejtoria përkatëse do të duhej të bënte më të mirën e mundshme, por edhe ta kërkonte përkrahjen e anëtarëve të kuvendit, në mënyrë që të paraqiste plane rregulluese urbane të detajuara dhe konkrete për secilin. Mandej duke iu referuar arsyetimit të paraqitur për propozim-vendimin në fjalë, tha se kuvendi ka nevojë që ta ketë një arsyetim më të detajuar, sepse arsyetimi në fjalë është shumë i shkurtër. Në fund tha se për ta bërë të zbatueshëm planin urban në fjalë, duhet të vendosen interesat e përgjithshme mbi interesat personale.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se Komuna e Vushtrrisë edhe para luftës e ka pasur një plan urbanistik, por kurrë nuk është respektuar. Pastaj tha se ndërtimet dhe uzurpimet e tokave, duke përfshirë edhe tokat bujqësore kanë ndodhur disa vite më herët, para marrjes së mandatit të tij si kryetar i komunës, prandaj qëllimi është që të bëhet një plan urbanistik dhe të parandalohen ndërtimet e egra dhe të instalohet një rregull i ndërtimeve, duke përfshirë edhe infrastrukturën e ujërave të zeza dhe të ujërave atmosferike. Në vazhdim tha se qëllimi i hartimit të planit

rregullues në fjalë është që nga ana e profesionistëve të përcaktohet hapësira e ndërimit në zonat në fjalë. Mandej, duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se nuk ka pasur nevojë të procedohet përmes kuvendit, pasi që më herët në kuvendin e komunës është aprovuar plani zhvillimor komunal, dhe në kuadër të PZHU-së janë paraparë 17 plane rregulluese, dhe në vitin e kaluar kuvendi i komunës ka marrë vendimi për t'i lejuar mjetet financiare për realizimin e 3 planeve rregulluese.

Idriz Ismajli, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se zona buzë magjistrales është konform planit zhvillimor urban dhe planit zhvillimor komunal që është aprovuar në vitin 2009. Gjithashtu njoftoi se zona në fjalë nuk është e paraparë për ndërtime të banimit, por është e paraparë për zhvillimin ekonomik. Në vazhdim paraqiti sqarimet shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar fjalimit të kryetarit të komunës, tha se është obligim që kuvendi i komunës ta nxjerrë vendimin për hartimin e këtyre planeve, dhe shtoi se planet rregullative bëhen në ato pjesë ku parashihet ndërtimi, e jo mbrojtja e tokës bujqësore, pasi që aty ku ka tokë bujqësore, nuk ka nevojë të bëhet plan rregullativ.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se akcenti i përbashkët në tërë këtë tematikë është mbrojtja e tokave bujqësore, dhe në rastin konkret ka bazë ligjore që i obligon institucionet komunale të ruajnë tokat bujqësore edhe pa këtë masë. Gjithashtu kërkoi që të vërtetohet se ku janë uzurpuar dhe ndërtuar ilegalisht në të kaluarën. Pastaj tha se nëse nuk merren masa të caktuara ligjore në të gjitha nivelet, atëherë do të ketë përsëri dështim të atyre planeve.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- tha se është aprovuar plani zhvillimor urban, dhe janë caktuar edhe zonat e planit rregullativ, kurse tash është faza kur duhet të merret vendim se në cilat zona do të fillohet hartimi i planit rregullativ.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 19 vota “për”, 11 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim përcaktohen prioritetet për hartimin e planeve rregulluese urbane në Komunën e Vushtrisë.

Planet rregulluese urbane përcaktohen sipas këtyre prioritetëve:

- ***Zona përgjatë magjistrales Prishtinë-Mitrovicë, përkatësisht prej fshatit Smrekonicë, deri në fshatin Gracë, në distancë prej 150 m, duke përfshirë të dy anët e magjistrales, në sipërfaqe prej 480 ha;***
- ***Zonat sipas planit zhvillimor urban nr. 7, 6, 8, 9 dhe 10, në sipërfaqe prej 236 ha;***
- ***Zonat sipas planit zhvillimor urban nr. 11, 13, 14, 15 dhe 17, në sipërfaqe prej 228 ha;***
- ***Zonat sipas planit zhvillimor urban nr. 4, 5, 12 dhe 15, në sipërfaqe prej 193 ha.***

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për emërimin e Bordit Këshillëdhënës për hartimin e planeve rregulluese të komunës.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- propozoi që Isak Hyseni, nga HANDIKOS-i të bëhet pjesë e bordit këshillëdhënës në fjalë, pasi që gjatë zbatimit të planit urbanistik është e paraparë që të gjitha ndërtimet që bëhen, duhet të kenë korsinë e veçantë për të hendikepuarit.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- tha se sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14 thuhet “kuvendi komunal emëron këshillin e ekspertëve të planifikimit”, kurse në propozim-vendimin në fjalë është emërtuar “bord”. Pastaj në emër të Grupit parlamentar të LDK-së tha se në ekipin e ekspertëve për planifikim, sipas udhëzimit

të Ministrisë për Planifikim Hapësinor, thuhet “këshilli duhet të përbëhet prej kryetarit, zv.kryetarit dhe 5 anëtarëve nga radha e personave profesionalë, shkencor, publik dhe personave tjerë kompetent për planifikim hapësinor, ndërkaq këshilli udhëheqet nga kryetari dhe zv.kryetari, të cilët i zgjedh këshilli”, kurse në propozim-vendimin në fjalë është paraqitur një këshill më tepër politik, sesa profesional. Në vazhdim tha se nëse ndryshohet ky këshill politik, LDK-ja do ta propozojë një ekspert të përmasave kombëtare, që do ta jepte kontributin e vet në këtë lëmi, dhe shtoi se anëtarët e KK-së nga LDK-ja nuk do të marrin pjesë në këshillin e propozuar, pasi që ky këshill më tepër është politik.

Idriz Ismajli, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm- njoftoi se Drejtoria për Urbanizëm gjatë hartimit të planit zhvillimor komunal dhe planit zhvillimor urban, i cili është aprovuar në vitin 2009, e ka pas këshillin e ekspertëve, i formuar konform ligjit dhe udhëzimit administrativ. Pastaj tha se shumë komuna kanë formuar borde këshillëdhënëse, duke e përfshirë stafin e tyre që e kanë pas në dispozicion. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se bordi në fjalë është propozuar që të përbëhet nga 28 vetë, kurse prej tyre, vetëm njëri është jashtë administratës së komunës. Pastaj tha se nëse ky bord quhet bord këshillues, pyeti se si mund të jepë këshilla profesionale një trup politik dhe shtoi se ky bord do të mund ta kishte funksionin mbikëqyrës, nëse do të bënte mbikëqyrjen e planit të caktuar. Në fund kërkoi sqarime pse është propozuar që bordi në fjalë të ketë 28 anëtarë.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, tha se qëllimi është që bordi të jetë gjithëpërfshirës, dhe gjithashtu e përkrahu që pjesë e bordit në fjalë të jetë edhe përfaqësuesi i HANDIKOS-it.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, 8 “kundër”, të tjerët “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me qëllim të ofrimit të këshillave profesionale gjatë procesit të hartimit të planeve rregulluese urbane për Komunën e Vushtrrisë, emërohet Bordi Këshillëdhënës në këtë përbërje:

Bajram Mulaku, kryetar i komunës; Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit; Dibran Përçuku, nënkryetar i komunës; Menderes Ibra, ing. i dipl. i Bujqësisë; Shpëtim Zhegrova, anëtar i KK-së; Naile Osmani, anëtare e KK-së; Avdullah Halimi, anëtar i KK-së; Makfirete Ademi, anëtare e KK-së; Sabri Ferati, anëtar i KK-së; Remzije Isufi, anëtare e KK-së; Xhemajl Pllana, anëtar i KK-së; Sabit Kadriu, anëtar i KK-së; Ergin Sunguri, anëtar i KK-së; Idriz Ismajli, drejtor i Drejt. për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit; Nezir Klinaku, drejtor i Drejt. për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë; Sami Istrefi, drejtor i Drejt. për Shërbime Publike; Nasuf Aliu, drejtor i Drejt. për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural; Idriz Muzaqi, drejtor i Drejt. për Administratë; Qerim Selimi, drejtor i Drejt. për Arsim; Safet Idrizi, drejtor i Drejt. për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale; Bajram Beqiri, drejtor i Drejt. për Inspektime; Naim Hyseni, drejtor i Drejt. për Mbrojtje dhe Shpëtim; Qamil Sahiti, drejtor i Drejt. për Kulturë, Rini dhe Sport; Isuf Jashari, drejtor i Drejt. për Buxhet dhe Financa; Fadil Muzaqi, drejtor i Drejt. për Prokurim Publik; Bojana Artonovic, udhëheqëse e Zyrës për Kthim dhe Komunitete; Isak Hyseni, përgjegjës i HANDIKOS-it në Vushtrri.

8. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i propozim-vendimit për përmirësimin e Vendimit 01Nr.59/11;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim përmirësohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.59/11, të datës 28.04.2011 për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim, të tokës në pronësi të komunës, për ndërtimin e objektit për Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve dhe Qendrën e Regjistrimit Civil.

Përmirësimi i vendimit në fjalë bëhet lidhur me parcelën kadastrale, kështu që në vend të parcelës kadastrale P-70202016-01119-1, fleta poseduese UL-70202016-01534, duhet të jetë parcela kadastrale P-70202016-00001-2, fleta poseduese UL-70202016-00045.

b. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara (të lira dhe të zotuara) nga të hyrat vetanake, nga viti 2011 në vitin 2012;

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë, dhe shtoi se është obligative me Ligjin për Buxhetin që të bëhet bartja e të hyrave nga viti paraprak në vitin vijues, dhe njoftoi se si shumë totale nuk ndryshon, por brenda për brenda mund të ketë ndonjë ndryshim eventual.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së e përkrahu propozim-vendimin në fjalë, dhe njëkohësisht shprehu shqetësimin që çdo vit ka mjete të pashfrytëzuara në shuma të mëdha dhe shtoi se do të ishte mirë që të bëhej tabelari edhe për mallra dhe shërbime, në mënyrë që të sqarohet se për çka janë zotuar këto mjete. Në fund tha se pasi që me buxhet janë të përcaktuara mjetet për paga dhe mëditje nga ministria përkatëse, për çfarë pagash do të shfrytëzohen këto mjete (46,912.00 €) në vitin 2012?

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- kërkoi sqarime nga drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa lidhur me propozim-vendimin në fjalë, duke kërkuar arsytet pse nuk janë shfrytëzuar këto mjete, dhe t'ua sqarojë anëtarëve të kuvendit pse kanë mbetur këto mjete të lira për secilën kategori. Në vazhdim tha se nëse konstatohet se deri te këto mjete të pashfrytëzuara ka ardhur për shkak të mosmenaxhimit të mirë dhe mungesës së planifikimit, duhet të japin përgjegjësi ata që kanë qenë kompetent për një menaxhim dhe planifikim më të mirë.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- duke iu referuar pyetjeve dhe vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit, tha se muaji nëntor është afati i fundit i mbylljes së zotimit të mjeteve, kurse të hyrat e muajve nëntor dhe dhjetor paraprakisht barten në vitin 2012. Kurse lidhur me tepricën e mjeteve të pagat, tha se të shkollat profesionale janë 32,912.00 € që barten nga provimet private. Kurse shuma prej 4,000.00 € të zyra e kryetarit, është bërë për shkak të mungesës buxhetore për pagesën e komiteteve konsultative. Kurse lidhur me mallrat dhe shërbimet, tha se të gjitha obligimet që vijnë në muajin 11 dhe 12, barten në vitin vijues, dhe shtoi se kjo është një procedurë e rregullt ligjore.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim barten mjetet e lira të mbetura nga viti 2011 në vitin 2012, në shumën prej 403,846.00 €. Shpërndarja bëhet në programet buxhetore.

Shuma e mjeteve të bartura në programin e pagave dhe mëditjeve (kodi 111), në shumën prej 31,979.00 €.

Shuma e mjeteve të bartura – mallra dhe shërbime (kodi 130), në shumën prej 130,783.00 €.

Shuma e mjeteve të bartura – shpenzimet komunale (kodi 132), në shumën prej 13,000.00 €.

Shuma e mjeteve të bartura – subvencione dhe transfere (kodi 200), në shumën prej 8,000.00 €.

Shuma e mjeteve të bartura – shpenzimet kapitale (kodi 300), në shumën prej 220,084.00 €.

c. Shqyrtimi i Informatës për dëmet e shkaktuara dhe gjendjen e rrugëve në Komunën e Vushtrrisë pas reshjeve të ditëve të fundit;

Naim Hyseni, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim- tha se në bazë të kompetencave që ka Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, pasi që kanë ndodhur erërat e fuqishme, ka dalë në terren dhe gjatë vizitave është konstatuar se në Komunën e Vushtrrisë ka ndodhur vetëm një rast, për të cilin rast drejtoria në fjalë ka kërkuar që të formohet një komision profesional në kuadër të bordit të drejtorëve, dhe pasi që është formuar komisioni, pas vizitës në vendin e ngjarjes ka konstatuar se janë shkaktuar dëme rreth 1,300.00 €, ndërsa dëme tjera nuk ka pas në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj tha se pas rënies së borës, disa zyrtarë nga drejtoria në fjalë kanë dalur në terren, dhe kanë vizituar fshatrat: Ashlan, lagjja e “Nemozhëve”, Kollë, Mihaliq, Studime, dhe në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike është intervenuar dhe janë zhblokuar të gjitha rrugët, ku ka pas nevojë të intervenohet, me përjashtim të lagjes “Islami” në Kollë.

ç. Pyetjet eventuale të anëtarëve të kuvendit.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të AAK-së propozoi që të formohet një fond rezervë për ndihmë qytetarëve në rastet emergjente. Në vazhdim paraqiti këto pyetje: pyeti Drejtorinë për Inspektive pse çmimi i bukës në Vushtrri është gjithmonë më i shtrenjti prej 0.40 €, kurse në qytetet tjera është 0.25 - 0.30 €? Pse qytetarët e vdekur në Komunën e Vushtrrisë që tri dekada nuk pajisen me certifikatat e vdekjes, dhe qëndrojnë në regjistrat me të gjallët edhe pas vitit 2000, prandaj pyeti çka ka ndërmarrë administrata komunale që 12 vjet? Pse nuk zbatohet në tërësi Ligji kundër duhanit në Komunën e Vushtrrisë? Pse firma “Egzoni” që 6 muaj nuk ua paguan sigurimin pensional të obligueshëm 18 punëtorëve të tri shkollave të mesme? Mandej kërkoi sqarime lidhur me dënimin prej një muaji me burgim për Shaip Shefikun, i cili është paditur nga komuna për ndërtim pa leje, kurse i dënuari pretendon që ka pasur aktvendim mbi legalizimin e objektit, dhe shtoi se ka me qindra ndërtues tjerë, të cilët kanë ndërtuar pa leje edhe në toka të uzurpuara, kurse është paditur vetëm rasti në fjalë. Në fund për të gjitha këto pyetje kërkoi përgjigje me shkrim.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së parashtrroi pyetje për avokaten e komunës se a e ushtron kryesuesi i kuvendit detyrën e tij në mënyrë të ligjshme?

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke iu referuar pyetjes së R.Ramaj, njoftoi se ia ka dërguar një kërkesë me shkrim MAPL-së, dhe përgjigjen që do ta merr, me kohë do ta informojë kuvendin e komunës.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar revistës komunale “Vicianë”, në të cilën thuhet që “Ministria e Drejtësisë si pronare e motelit, për vitin 2011 ka paraparë shumën prej 236.000 € për renovimin e tij”, dhe shtoi se deri më tani nuk është bërë renovimi, dhe propozoi që Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë që Gjykatën Komunale dhe Stacionin Policor të Vushtrrisë t’i zhvendosen atje, pasi që aktualisht gjenden në vende shumë të papërshtatshme, dhe në të dyja ka raste emergjente. Pastaj duke iu referuar të dhënave të paraqitura nga komuna, thuhet se “Llamkosi” i ka borxh komunës rreth 80.000 € obligim për tatim në pronë dhe taksë në firmë, prandaj propozoi që për këtë borxh komuna të kërkojë kompensim jomonetar nga “Llamkosi”, dhe përmendi si shembull kompensimin për furnizim me kontejnerë për shumën në fjalë. Mandej kërkoi nga autoritetet komunale në Vushtrri që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës pjesën e rrugës së

magjistrales Prishtinë-Mitrovicë (nga "Emona" deri te "Banjska Trans") të bëjë shtrimin e dy anëve me rërë, pasi që ka shumë kalimtarë që frekuentojnë dhe vazhdimisht e rrezikojnë jetën e tyre, ku edhe ka pasur raste fatale.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit- tha se nuk janë pastruar nga bora rrugët lokale të asfaltuara që shkojnë për Stroc, Beçuk dhe Zhilivodë, prandaj kërkoi që të bëhet pastrimi i rrugëve në fjalë. Mandej pyeti kur është afati i përfundimit të punimeve për Urën e Prelluzhës, dhe shtoi se në bazë të informatave të marra nga punëkryesi, në projekt nuk është paraparë asfaltimi i dy pjesëve të rrugës që lidhen me urën, në largësi prej 200 metrave.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- kërkoi nga autoritetet komunale në Vushtrri që të angazhohen dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës të asfaltojnë rrugën e cila lidh Vushtrrinë me fshatrat e Artakollit. Pastaj tha se ka kërkesa dhe pakënaqësi të mëdha nga punëtorët teknik të shkollave, me ç'rast kërkoi nga Drejtoria për Arsim që ta rishqyrtojë marrëveshjen e lidhur me kompaninë "Egzoni", pasi që kompania në fjalë është duke i shantazhuar punëtorët teknik me kërcënim për largim nga puna, dhe nuk ua bën punëtorëve pagesat për sigurimin pensional. Gjithashtu ritheksoi se nuk ka marrë përgjigje me shkrim për çështjen që ka ngritur lidhur me nxënësit që kanë marrë diploma në disa shkolla në kundërshtim me ligjin.

Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim- duke iu referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit, tha se Drejtoria për Arsim ka kërkuar privatizimin e punëtorëve teknik në shkolla dhe kompania "Egzoni" është zgjedhur në bazë të Ligjit të Prokurimit, dhe Drejtoria për Arsim ka lëshuar një njoftim se punëtorët të cilët do të kryejnë shërbime private nuk mund ta kenë pagën më të vogël se sa paga që ka qenë në shërbime publike. Kurse lidhur me pagesat nga kompania në fjalë për sigurimin pensional, në bazë të informatave nga Drejtoria e Prokurimit, janë duke u realizuar pagesat në fjalë, duke shtuar që çështjen e kompanisë do ta inspektojnë inspektorët e punës. Kurse lidhur me pyetjen për provimin e maturës, tha se çështja e rritjes së pikëve është çështje e Njësisë së Standardeve të Vlerësimit, e cila është nën kompetencën e Ministrisë së Arsimit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15.

**Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi**